



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "As Tech" Sh.P.K. të datës 27.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera" me nr. të prokurimit 616-24-5477-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "As Tech" Sh.P.K. të datës 27.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera" me nr. të prokurimit 616-24-5477-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "As Tech" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera" me nr. të prokurimit 616-24-5477-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit mund të klasifikohen në dy grupe kryesore ashtu që në grupin e parë (pretendimet 1, 2 dhe 3) parashtruesi pretendon se AK nuk ka lejuar qasjen në dokumente publike sipas kërkesës së parashtruesit. Ndërsa në grupin e dytë (pretendimet 4, 5 dhe 6) parashtruesi pretendon se arsyet për eliminimin e ofertës së tij si ofertë të papërgjegjshme janë arsye të pabazuara dhe të pasakta.

AK ka trajtuar pretendimet ankimore të parashtruesit sikurse në vijim. Lidhur me grupin e parë të pretendimeve ankimore duhet sqaruar se AK ka lejuar qasjen në përputhje të plotë me LPP për parashtruesin dhe për të gjithë tenderuesit e tjerë. Për këtë fakt ekzistojnë edhe procesverbalet për lejimin e qasjes. Prandaj pretendimet ankimore të parashtruesit në grupin e parë (nr. 1, 2 dhe 3) janë të pabazuara. Lidhur me grupin e dytë të pretendimeve ankimore duhet sqaruar se parashtruesi në parim nuk i kundërshton të gjeturat e komisionit vlerësues por vetëm kërkon që të përmes sqarimeve shtesë të lejohet parashtruesi të ndryshoj/plotësoj ofertën e tij. Pas administrimit me dokumentet me të cilat ka ofertuar parashtruesi është konfirmuar se të gjitha konstatimet e komisionit vlerësues janë të sakta. Prandaj pretendimet ankimore sipas grupit të dytë (nr. 4, 5 dhe 6) janë të pabazuara.

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK komisioni vlerësues ka gjetur se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme për arsyet si në vijim:

***Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:***

**Sipas Vendimit nga ZPP deklarojmë se OE- As Tech SH.P.K është i pa përgjegjshëm për arsyeje se për udhëheqësin e punishtes – Bachelor ose Inxhinier i dip. I Termoenergjetikës i mungon CV- e nënshkruar, CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-se, i mungon se paku një kontrate, kontrate e ngjashme e realizuar ne tri vitet e fundit. Pike tjetër qe nuk e ka përmbushur OE AS Tech është se ne raportin e vlerësimit te riskut ne ofertën e tij ka paraqitur vetëm tri pozita: administratoren, drejtorin dhe servisuesin e pajisjeve shtëpiake:, po ashtu OE- AS Tech ka ofertuar me çmime abnormalisht me te ulëta ne pozicionet 43,44 dhe 66.**

Nga dokumentet me të cilat ka ofertuar parashtruesi është gjetur se të gjitha arsyet për eliminimin e tij nga AP janë të sakta dhe të qëndrueshme në tërësi. Ndërsa sa i përket pjesës së pretendimeve ku parashtruesi kërkon që të plotësoj ofertën e tij përmes sqarimeve shtesë, një veprim i tillë do të përbënte ndryshim material të ofertës së tij që do të manifestonte edhe një arsye shtesë për eliminim. Megjithatë në rastin hipotetik kur do të mund të lejohej një veprim i tillë, sërish kjo nuk do të ndryshonte epilogun e procedurës për shkak të të gjeturave tjera të komisionit vlerësues që e rikonfirmojnë papërgjegjshmërinë e ofertës së parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 02.08.2024

Visar SHEHU  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.